



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË /OPSTINSKI SUD ZA PREKRSAJE U PRISTINI/MUNICIPAL OFFENCES COURT IN PRISTINA

Nr.regj. 16924/2010

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës Vjollca Komoni nga Prishtina, për kundërvajtjen nga neni 6 parag.2 lidhur me nenin 16 paragrafi 1 pika 2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollën e Pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publik, e ne bazë të nenit 73,74,195,198 al. 1 pika 2 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, merr këtë:

#### AKTVENDIM

**PEZULLOHET:** Procedura kundërvajtëse ndaj të pandehurës Vjollca Shaip Komoni e lindur , me 1953 në Gjakovë, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë rr.Hamëz Jashari nr.33 për kundërvajtjen nga neni 6 paragr. 2 lidhur me nenin 16 paragr.1 pika 2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollën e Pasurisë dhe dhuratave të zyrtarëve të lartë publik konform nenit 198.parag.1.pika 2 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, për shkak të ekzistimit të rrethanave që e përjashtojnë përgjegjësinë kundërvajtëse.

Shpenzime të procedurës nuk ka patur.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palës dhe ushtruesit të kërkesës.

#### Arsyetim

**Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë**, parashtroj gjykatës kërkesën nr.001/2310/10 më dt. 15.06.2010 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurës Vjosa Komoni dhe për kundërvajtjen nga neni 6 paragr.2 lidhur me nenin 16 paragr.1 pika 2 të LDPKP dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publik.

Pasi që Gjykata e mori kërkesën për fillim të procedurës dhe konstatoi se e njëjta nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 135 paragr.1 pika 1 të LMK-së, u kërkua nga parashtruesi që të bëjë plotësimin e saj. Në afatin e caktuar ligjor Agjencia kundër korrupsionit veprroi sipas kërkesës së Gjykatës duke i evituar të metat lidhur me identitetin e prodekanes për qështje mësimore në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike.

Në seancën gjyqësore të caktuar për datë 24.02.2011 gjyqtari e dëgjoi të pandehurën Vjollca Komoni, e cila në mbrojtjen e vet deklaroi se nuk ka qenë e informuar me kohë lidhur me këtë obligim nga Rektorati i Univerzitetit të Prishtinës, dhe si prodekane e FIEK nuk ka patur kurrfarë arsye për mos deklarim të pasurisë. Pas afatit të caktuar ligjor për deklarimin e pasurisë është informuar gojarisht dhe menjëherë e ka plotësuar formularin i cili është refuzuar nga AKK si i dorëzuar në kohën jo të duhur, andaj sipas saj ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë.

Nga vlerësimi i të dhënave të parashtruara në kërkesë, deklarata e të pandehurës, nga shiqimi dhe vlerësimi i shkresave tjera të deponuara në këtë lëndë, Gjykata konstatoi se në rastin konkret vërtetë ekzistojnë rrethana, të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë kundërvajtëse, andaj në vështrim të nenit 198 paragr.1 pika 2 të LMK-së, ndaj të pandehurës të përmendur më lartë u pezullua procedura dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë 8 ditë pas marrjes së të njëjtit nëpërmjet kësaj Gjykate pa taksë..

**U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**

Me dt. 03.03.2011

**KRYETARI I GJYKATËS**  
Mustafë Selimi